VENDIM
Nr.801, datë 16.11.2011

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË SHPALLJES DHE TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT E TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE INSTITUCIONET E SAJ TË VARËSISË, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 26.6.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të institucioneve të saj të varësisë, si autoritete kontraktore, për të përfunduar, brenda datës 20 dhjetor 2011, procedurat e prokurimit për shërbime dhe punë civile, me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2011, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen dhe lidhja e kontratave përkatëse dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, institucionet e saj të varësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha